



Kolegji AAB

CILËSI. LIDERSHIP. SUKSES!

UDHËZUES PËR TEMË TË DIPLOMËS

Programet Bachelor (BA, BSc)

2014

nga zyra për Sigurimin e cilësisë

Përmbajtja:

Çfarë është një disertacion ose tema e diplomimit?	3
Organizimi i përzgjedhjes së temës	4
Etika dhe mirësjellja akademike	5
Pse duhet të përmenden dhe citohen referencat?	6
Forma e paraqitjes.....	6
Për nga forma punimi i tezës së diplomës për master duhet të duket si vijon:.....	6
Paraqitja e temës së diplomës/disertacionit.....	7
Përshkrime të faqeve më në detaje	8
Referencat	12
Mentorimi, konsultimet, vlerësimi dhe afati i dorëzimit	14
Informacione teknike dhe informacione rreth pritshmërisë	17
Udhëzime mbi numrin e faqeve ose fjalëve.....	17
Udhëzime mbi margjinat, fontin dhe hapësirën në mes të rreshtave	17

Çfarë është një disertacion ose tema e diplomimit?

Tema e diplomës ose siç quhet ndryshe disertacioni, apo edhe projekt hulumtimi, është ndoshta detyra apo projekti më i rëndësishëm që një student do të ndërmarrë dhe të punojë gjatë kohës në universitet, dhe është shpesh një tregues kryesor i aftësive komunikuese, studiuere dhe hulumtuese të një studenti.

Një disertacion i përmbahet disa parimeve bazë të shkrimit akademik:

- Kjo është një pjesë e strukturuar e të shkruarit që zhvillon një linjë të qartë të mendimit (një 'argument') në përgjigje të një pyetje qendrore ose propozimi ('teza').
- Një disertacion është një pjesë e zgjatur e punës, zakonisht i ndarë në kapituj, dhe përmban një ekzaminim në mënyrë të konsiderueshme më të detajuar për çështjet në fushën e adresuar dhe dëshmi apo evidenca të ndryshme në lidhje me fushën e studimit, gjë që kërkon më shumë punë se në rastin e punimit të një eseje.
- Ju si studentë, zakonisht keni shumë më shumë përgjegjësi në zgjedhjen tuaj për temë kërkimore nga një fushë apo lëndë që juve u ka pëlqyer me se shumti, ju do të keni edhe përgjegjësinë e gjetjes së materialit/materialeve mbështetëse për të punuar në temën tuaj.
- Disertacioni juaj dëshmon aftësinë tuaj për të kryer studimin dhe hulumtimin në mënyrë të pavarur, por me mbështetjen e një profesori i cili do të jetë mentori juaj.
- Secili student do të ketë një mentor (këshilltar), i cili do të përzgjidhet nga ana juaj, por ai/ajo duhet të jetë i doktoruar në fushën përkatëse që ju keni përzgjedhur temën e disertacionit tuaj.
- Studenti duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje metodologjisë së hulumtimit që do të përdoret në arritjen e konkluzioneve të ndryshme apo rekomandimeve në disertacionin tuaj. Këtë studentët mund ta diskutojnë edhe me mentorin e tyre.
- Për ata studentë të cilët do të përdorin një analizë kuantitative me të dhëna të ndryshme, duhet të sigurohen në përdorimin e software-ave të duhur për bërjen e analizave kuantitative. Këtë studentët mund ta diskutojnë edhe me mentorin e tyre.

Një disertacion apo projekt në vitin e fundit, si një formë e vlerësimit ndryshon nga vlerësimet e tjera që keni pasur nëpër lëndët e tjera. Pritshmëria është që ju, si studentë, të merrni përgjegjësinë për të mësuarit tuaj dhe që ju të bëni rishikimin e literaturës ekzistuese për një temë që keni përzgjedhur, ju të bëni zgjedhjen e një metodologjie për ndërmarrjen e një studimi, të shkruani gjetjet tuaja dhe t'i diskutoni rezultatet në një seksion diskutimi – që është mbrojtja e temës së diplomës.

Për shumicën e studentëve, një element i rëndësishëm i studimit të vitit të fundit është një projekt i pavarur i të mësuarit. Sipas Todd et al (2004), ndërsa këto projekte mund të ndryshojnë në masë të madhe në qëllimin dhe natyrën e tyre (p.sh. një disertacion i zgjeruar apo ese zgjeruar; projektim dhe prodhim i disa llojeve të artefakteve, projekteve hulumtuese dhe seminareve të ndryshme, raporte, ekspozita të ndryshme dhe diskutime, etj) shumica e tyre ndajnë një numër të

ngjashëm karakteristikash. Këto karakteristika të ngjashme janë cekur më poshtë, dhe se caktimi i projektit final të pavarur, apo disertacionit tuaj, ose temës së diplomimit, varet edhe nga fakulteti dhe fusha e studimit tuaj.

- **Së pari**, studenti përcakton fokusin dhe drejtimin e punës së tyre.
- **Së dyti**, kjo punë kryhet në baza individuale - edhe pse zakonisht ka mbështetje nga mentori (siç u cek më larte) dhe studenti merr drejtimin ose orientimin në punën e tij/saj.
- **Së treti**, ka zakonisht një komponent kërkimor, i cili është thelbësor për projektin, duke kërkuar mbledhjen e të dhënave parësore dhe / ose analiza e të dhënave ekzistuese apo të dhënave sekondare.
- **Së fundi**, studenti do të ketë një angazhim më të gjatë me temën e zgjedhur se sa në rastin e të shkruarit të një eseje ose detyrave të tjera që përcaktohen nga profesorët nëpër lëndët e ndryshme. Pra, si rrjedhojë, nga studenti pritet që disertacioni i tij/saj të jetë më i 'thelle' në analizë-bërje dhe paraqitje të rezultateve të hulumtuara.

Organizimi i përzgjedhjes së temës

- Studenti duhet të përzgjedhë vetë temën apo fushën e disertacionit të tij/saj në vitin e fundit të studimeve pasi që t'i ketë dëgjuar të gjitha ligjëratat e të gjitha lëndëve.
- Profesorët do të japin rekomandime për temat e ndryshme në fushën apo lëndën e tyre gjatë ligjëratave të tyre.
- Studentët inkurajohen që edhe vetë të mendojnë në një fushë që atyre iu intereson me së shumti. Pastaj atë temë që po mendojnë ta përzgjedhin studentët duhet ta diskutojnë me ndonjë profesor të asaj fushe.
- Studentët do të marrin shembuj të temave që ata mund t'i përzgjedhin rregullisht nga profesorët e tyre, mirëpo studentët duhet të bëjnë përzgjedhjen në mënyrë të pavarur dhe të vendosin në atë temë ku ata/ato ndihen se do të mundë të kontribuojnë dhe mund të punojnë në atë temë.
- Pasi që studenti përzgjedh fushën, përkatësisht temën e diplomimit apo disertacionit, ai/ajo duhet të përzgjedhë edhe mentorin.
- Mentori është një profesor i doktoruar në një fushë apo lëmi të caktuar, i cili ka për detyrë të monitorojë apo vëzhgojë punën tuaj. Por jo vetëm kaq, një mentor, ka për detyrë t'i këshillojë studentët dhe t'i orientojë ata në kryerjen sa më të mirë të disertacionit të tyre.
- Inkurajohen të gjithë studentët që në fillim të vitit të tyre të fundit të studimeve, të fillojnë të mendojnë se në cilat tema ata më së shumti janë të interesuar, dhe të fillojnë konsultimet me profesorët e tyre, për të bërë një përzgjedhje të duhur të disertacionit.
- Përzgjedhja e temës është shumë e rëndësishme dhe pothuajse gjysma e punës së kryer.
- Siguroheni si studentë që atë temë që keni përzgjedhur, apo jeni në prag të përzgjedhjes, të jeni të gatshëm që t'i gjeni faktet, të dhënat, literaturën, pajisjet apo edhe fizibilitetin kohor, në mënyrë që disertacioni juaj të jetë sukses.

Etika dhe mirësjellja akademike

- Shkrimi i një disertacioni ka përgjegjësi të mëdha. Në lëndë apo kurse të tjera është e përcaktuar ajo që profesorët duan që ju të gjeni, të mësoni, të testoni apo të kuptoni. Disertacioni është rreth mendimit tuaj individual dhe drejtimi apo orientimi i punimit tuaj bëhet nga vetë ju (me këshilla nga mentori juaj) - Ka më shumë liri të përfshira në atë se si ju mund ta trajtoni një temë nga këndvështrimi juaj dhe se në cilat aspekte të një çështje ju do të orientoheni, mirëpo edhe përgjegjësia është më e madhe.
- Ju duhet të siguroheni që tema juaj nuk është kopjim apo duplikim i një punimi tjetër të një autori apo autorëve të tjerë. Marrja e punimeve të tjera dhe përdorimi i tyre sikur të ishte i juaji, konsiderohet krim akademik dhe ka ndëshkime. Kjo quhet **plagjiaturë**.
- Plagjiatura ndëshkohet nga Universiteti AAB, sipas rregullores. Lexojeni këtë dokument më vëmendje para se të filloni shkrimin e disertacionit tuaj.
- Në Universitetin AAB, sjellje jo të mira akademike dhe pandershmëri akademike konsiderohen:
 - *Plagjiatura*
 - *Dorëzimi i punimit të njëjtë më shumë se një herë*
 - *Marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta mes studentëve*
 - *Kopjimi gjatë provimeve dhe kollokfiumeve*
 - *Paraqitja jo e vërtetë e burimeve apo referencave, dhe citimi jo adekuat.*
 - *Kopjime e tjera dhe mos referencime/citime adekuate***Të gjitha këto kanë ndëshkime.**
- Gjatë shkrimit të punimit tuaj, është në rregull përdorimi i punës së tjetrit, por nëse përdoret duke **u cituar dhe referencuar sipas rregullave**, respektivisht **Sistemi Harvard** apo Vancouver i citimit (ose sistemet e tjera). Ju lutemi lexojeni udhëzuesin për këtë.
- Në fakt, është me rëndësi përdorimi i shumë burimeve të ndryshme për një temë të caktuar në shkrimin e punimit tuaj. Profesori mund t'ju vlerësojë për referencat të burimeve të ndryshme. Kjo tregon se keni hulumtuar dhe lexuar shumë apo disa burime/artikuj.
- Çdo citat nga veprat e botuara apo të pabotuara të autoreve të tjerë, duhet të identifikohet qartë duke u vendosur **brenda thonjëzave**, dhe studentët duhet të identifikojnë burimet e tyre saktë dhe sa më të plota që të jetë e mundur.

Pse duhet të përmenden dhe citohen referencat?

- Duke iu referuar materialit që keni përdorur si burim, ju i jepni autoritet punës suaj dhe në të njëjtën kohë tregoni gjerësinë e hulumtimit tuaj.
- Të gjitha burimet duhet të citohen dhe të gjitha referencat të ofrohen sipas stilit të referencimit të kërkuar. Për më shume lexo ***Rregulloren për citim dhe referenca të Universitetit AAB.***
- Lista juaj e citateve do t'ia japë lexuesit mundësinë e gjetjes së informacionit
- Mos përdorimi i burimeve të informacionit në mënyrë të duhur për një ese, raport, projekt, punim, plan, analizë, artikull apo libër përbën plagjiaturë, dhe mund të dënoheni për këtë. ***Rregulloret dhe ndëshkimet për plagjiaturë në Universitetin AAB*** janë të theksuara në dokumentin për sjellje jo të mira akademike. Lexojeni këtë dokument më vëmendje.
- Studentët duhet të jenë të vetëdijshëm se Universiteti AAB e merr shumë seriozisht rastin e plagjiaturës dhe studentët mund të përjashtohen për këtë.

Forma e paraqitjes

Për nga forma punimi i tezës së diplomës për master duhet të duket si vijon:

Më shumë informata janë dhënë në tabelën më poshtë:

- Faqja e titullit/Ballina:
 - Emri i Kolegjit
 - Emri i fakultetit/programit
 - Stema
 - Titulli i temes
 - Emri i mentorit dhe emri i kandidatit
 - Viti i punimit
- Pastaj nje faqe duhet te jete e zbrazet
- Pastaj duhet te krijohet nje faqe me te dhenat identike qe jane ne balline
- Permbajtja
- Hyrja,
- Shtjellimi i temave,
- Konkluzionet/Përfundimet dhe
- Bibliografia.

Paraqitja e temës së diplomës/disertacionit

Faqet	Paraqitja e punimit të shkruar	Përmbajtja
Faqja e parë	Titulli i punimit	Titulli i punimit Emri juaj/Nr. i ID-se Emri i mentorit dhe grada e tij Titulli i lëndës/Programi i studimit dhe niveli Data
Faqja e dytë	Përmbajtja	Përmbajtja e punimit me numrat e faqeve për secilin kapitull, nënkapitull, titull, nëntitull, etj.
Faqja e tretë	Lista e tabelave/grafikëve	E gjithë lista e tabelave të përdorura, grafikëve, figurave, ekspozitave, veprave, etj Numri në faqen ku këto tabela, grafika etj gjinden.
Faqja e katërt	Lista e shkurtesave (nëse ka)	Lista e të gjitha shkurtesave (nëse keni përdorur në punim), të paraqitura në mënyrë alfabetike.
Faqja e pestë	Abstrakti	Abstrakti paraqet një përmbledhje të asaj që ju jeni përpjekur të zbuloni, atë që keni zbuluar dhe përfundimet që keni nxjerrë.
Zakonisht 1 deri në 2 faqe	Hyrje	Të shkruarit e Hyrjes, fillon me një perspektivë të gjerë mbi çështjen që po hulumtohet dhe përfundon me një qasje të ngushtuar rreth çështjes që po diskutohet.
Zakonisht 2 deri në 4 faqe	Rishikimi i Literaturës	Kryesisht ka të bëjë me përshkrimin e literaturës relevante me çështjen që ju e shtjelloni. Duhet ta paraqitni se si keni ngritur temën tuaj kërkimore dhe se si ajo përshtatet me punën ekzistuese në atë fushë – pune ekzistuese e cila është bërë nga hulumtuesit e tjerë.
Zakonisht 1 deri në 2 faqe	Metodologjia	Këtu duhet të përgjigjeni në pyetjen se ‘si i kam zgjedhur metodat për t’u përgjigjur në pyetjen time të disertacionit, se si do të më ndihmojë kjo metodologji në arritjen e konkluzioneve në punimin tim, pikat e forta dhe të dobëta të kësaj qasjeje si një mjet për gjenerimin e njohurive të reja për atë fushë, çfarë pajisje kam përdorur, cilat programe në kompjuter kam përdorur dhe pse, dhe se si unë e kam bërë hulumtimin’.
Pjesa kryesore e punimit. Numri i faqeve varet nga tema.	Të gjeturat/Rezultatet	Të gjitha të gjeturat apo rezultatet e punimit apo hulumtimit tuaj duhet të shfaqen këtu në atë formë që kontribuon për të dhëne kuptim punimit tuaj. Paraqitja e rezultateve duhet të bëhet në mënyrë sa më të qartë për lexuesin.

Pjesa kryesore e punimit. Numri i faqeve varet nga tema.	Diskutimi	Qëllimi i kësaj pjese të punimit është interpretimi, analizë-bërja dhe evaluimi i rezultateve të arritura.
Zakonisht 1 deri në 3 faqe	Konkluzioni/Përfundimi dhe (nëse është e përshtatshme ose e duhur) rekomandimet	Përfundimi i punimit duhet të kthehet prapë në Hyrje dhe vazhdon duke i dhënë një përgjigje të shkurtër pyetjes të cilës ju keni dashur t'i përgjigjeni në këtë punim.
Numri i faqeve varet nga numri i burimeve apo referencave të përdorura në punim. Zakonisht 1 deri në 3 faqe	Bibliografia/Referencat	Këtu duhet të shkruhet një listë e të gjitha librave, artikujve ditare, zhurnalëve akademike, revistave të ndryshme, faqeve të internetit, gazetave dhe burime të tjera që ju keni përdorur në disertacion tuaj.
Numri i faqeve varet nga numri i të dhënave që doni t'i prezantoni në këtë pjesë të punimit.	Apendikset	Këtu duhet të paraqiten p.sh. Pyetësorët, transkriptet e intervistave, transkriptet e anketave, tabela të detajuara, grafika të detajuara, formula e modele ekonometrike të detajuara, etj. Kjo varet shumë nga fusha e studimit tuaj.

Përshkrime të faqeve më në detaje

Abstrakt

Faqja e dytë e punimit duhet të jetë e rezervuar për Abstraktin. Ky titull duhet të vendoset në mes të faqes. Abstrakti paraqet një përmbledhje të asaj që ju jeni përpjekur të zbuloni, atë që keni zbuluar dhe përfundimet që keni nxjerrë. Zakonisht abstrakti përpilohet pasi të jetë përfunduar punimi, megjithatë kërkon një përqendrim të theksuar për ta punuar. Abstrakti do të duhet të jetë i përbërë prej 100 – 150 fjalëve, dhe është shumë e rëndësishme të respektohet ky rregull. Abstrakti duhet të përfshijë hipotezat, metodologjinë, rezultatet dhe përfundimet.

I. Hyrje

Punimi do të duhet të vazhdojë me titullin Hyrje. Të shkruarit e Hyrjes fillon me një perspektivë të gjerë mbi çështjen që po hulumtohet dhe përfundon me një qasje të ngushtuar rreth çështjes që po diskutohet.

Së pari duhet të diskutohet çështja në përgjithësi, pastaj të bëhet një përshkrim i shkurtë i literaturës relevante, dhe të përfundojë me një përshkrim të qartë dhe të detajuar të qëllimit për hulumtimin tuaj dhe të parashtrohet hipoteza e juaj.

Ju duhet të përfundoni hyrjen me një fjali që përmbledh qëllimin dhe arsyetimin e hulumtimit që po e bëni. Në këtë pjesë ju duhet të tregoni se çfarë pritje keni për rezultatet (duke u bazuar në diskutimet teorike dhe hulumtimeve të tjera që janë cituar më herët në hyrje). Në rast se nuk keni pritje për rezultatet atëherë shënoni edhe atë. Këtu duhet të shpjegoni edhe mënyrën e organizimit të punimit, në mënyrë që lexuesi të jetë në dijeni se çka e pret në lexim.

II. Rishikimi i literaturës

Përshkrimi i Literaturës kryesisht ka të bëjë me përshkrimin e literaturës relevante me çështjen që ju e shtjelloni. Zakonisht nuk duhet të fokusohet në specifikat e çështjes suaj, por duhet të marrë në shqyrtim edhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me çështjen që ju e shtjelloni. Gjithsesi duhet të përcaktohet qartë forma e citimit.

Ekzistojnë dis rregulla të citimit si; "*Jones and Jones (1994) tregojnë se ...*" apo "*... në hulumtimin e luftës dhe PTSD (Jones and Jones, 1994) argumenton....*" Rregullat e citimit varen shumë nga stili i referencimit. Si studentë ju duhet të referoheni tek rregullorja për citim të punimit. Duhet të diskutoni me dekanatin se çfarë stili te referencimit ata dëshirojnë të përdorin. Stili i citimit dhe referencimit me i përdoruri është stili Harvard, stili Vancouver dhe Chicago. Secili nga këto stile është i pranueshëm, por duhet të cekni në metodologjinë e punimit se cili stil është përdorur në punimit tuaj.

III. Metodologjia

Kjo pjesë e punimit vazhdon me titull në mes të faqes "Metodologjia" dhe duhet të ndahet në katër nën tituj. Kjo ndarje varet edhe nga fusha e studimit apo nga fakulteti. Mund të këtë metodologji edhe pa këta nëntituj. Ju duhet të vendoseni së bashku me mentorin e juaj se si dëshironi ta paraqitni metodologjinë tuaj të punimit për lexuesin. Metodologjia duhet të jetë e shkruar qartë dhe shumë e kuptueshme për lexuesin. Dekanatet veç e veç duhet të vendosin për mënyrën e shkruarit të metodologjisë. Për shkencat sociale, ekonomike, shkencore, etj, shpeshherë përdoret kjo mënyrë e të shkruarit të metodologjisë.

1) Pjesëmarrësit në anketime/pyetësorë ose të dhënat e përdorura

Në këtë pjesë duhet të jepen këto informata:

- Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ose respondentëve ose të dhënat e përdorura
- Popullata prej nga është marrë mostra (p.sh; studentët e vitit të parë të Universitetit AAB), ose mostra e përdorur e të dhënave ekzistuese
- Përzgjedhja (e rastësishme, vullnetare, etj), apo përzgjedhja e të dhënave
- Detajet e tjera që mund të kenë ndikim në rezultatet e hulumtimit si : mosha, gjinia, edukimi, dijenia e pjesëmarrësve për çështjen që do të hulumtohet
- Burimet e të dhënave të përdorura (p.sh. World Bank, FMN, Banka Qendrore, Komuna, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Enti i Statistikave i Kosovës, etj)

2) Aparatura / mjetet / programet kompjuterike

- Këtu nuk mjafton vetëm të renditen mjetet që janë përdorur, por ato duhet të specifikohen më në detaje në mënyrë që lexuesi ta kuptojë se për çka është fjala
- Fakultetet e ndryshme përdorin programe softwareke të ndryshme
 - (p.sh. Ekonomiku, Shkencat Sociale mund të përdorin IBM SPSS, Excel, EViews, STATA etj)
 - (p.sh. Arkitektura, dhe Artet mund të përdorin AUTO CAD, Adobe Professional, PhotoShop, etj)
 - (p.sh. Shkencat Kompjuterike mund të përdorin VBA, Liquid XML Studio, Netbeans, Java Platform, Access, etj)

3) Dizajni eksperimental

- Në këtë pjesë duhet të përshkruhet dizajni apo modelet. Të arsyetohet zgjedhja juaj për përparësitë e këtij dizajni/modeli.

- Të shpjegohen variablat e varura dhe të pavarura dhe të paraqiten formulat ekonometrike nëse është nevoja.
- Mënyra se si pjesëmarrësit janë ndarë në grupe dhe të gjitha informatat e tjera të cilat i kanë kontribuar dizajnit/modelit tuaj.

3) Procedura

- Në këtë pjesë përshkruhet e gjitha që ka ndodhur prej momentit të takimit të eksperimentuesit me pjesëmarrësit dhe deri në momentin e përfundimit të takimit.
- Prandaj duhet të përshkruhen të gjitha ngjarjet e rëndësishme që kanë ndodhur gjatë hulumtimit
- Duhet të paraqitet procedura e intervistimit, anketimit, formulimit të modelit, apo të tjera procedura që përkojnë me fushën tuaj të studimit.

IV. Të gjeturat / Rezultatet

Paraqitja e rezultateve apo të gjeturave duhet të bëhet në mënyrë sa më të qartë për lexuesin. Të dhënat dhe tabelat statistikore nuk do të duhej të përfshihen në këtë pjesë të punimit, por në formë të shtojcave.

Pjesa e rezultateve duhet të përfshijë të dhëna të grumbulluara qartë, mesatare, devijimin standard, dhe intervalet e konfidencës në formë të tabelave. Në rezultatet apo të gjeturat, do të duhet të fillohet me të arriturat kryesore e pastaj të vazhdohet deri tek ato më pak kryesore.

V. Diskutimi

Pjesa e diskutimit zakonisht është pjesa e parafundit e këtij punimi. Qëllimi i kësaj pjese të punimit është interpretimi i rezultateve të arritura apo të gjeturave. Komentimi dhe përshkrimi i grafikëve të fituara nga rezultatet dhe të gjeturat. Këtu gjithashtu duhet të përfshihen edhe rezultatet jo të zakonshme të cilat janë arritur.

Gjithmonë mundohuni të jepni interpretim sa më të thjeshtë rezultateve dhe se ky interpretim të jetë i juaji në mënyrë që të dal sa më origjinal. Diskutimi duhet të përfshijë edhe pyetjen hulumtuese dhe si rezultatet e arritura i përgjigjen kësaj pyetjeje. Për dallim nga hyrja, diskutimi fillon nga perspektiva e ngushtë mbi çështjen dhe vazhdon me zgjerimin e saj.

VI. Konkluzioni / Përfundimi dhe Rekomandimet

Ky është edhe kapitulli apo pjesa e fundit e punimit. Ky kapitull duhet të mbledhë së bashku përfundimet, si dhe herë pas here nëse është e arsyeshme dhe e nevojshme të vë në dukje ndonjë rekomandim për praktikë. Ju nuk duhet të përfshini ide apo analiza të reja në këtë fazë - ato duhet të ishin trajtuar në seksionin e diskutimit. Ju mund të përfshini një reflektim mbi punën kërkimore që keni bërë dhe gjithashtu të identifikoni mënyrat në të cilat ju, apo të tjerët, mund të zhvillojnë kërkime të mëtejshme në fushën e njëjtte ose në fusha të ngjashme.

Referencat

Zakonisht faja e referencave ka të bëjë me renditjen e të gjitha burimeve që keni përdorur në punim, sipas alfabetit në bazë të mbiemrit të autorit. Të gjitha burimet duhet të citohen në këtë pjesë.

- **Shtojcat dhe Figurat**
 - Kjo është pjesa ku kryesisht shënohen të dhënat, figurat, tabelat statistikore, kalkulimet etj. Secila shtojcë duhet të ketë titull.
- **Referencat në tekst**
 - Shënoni emrin e autorit dhe vitin p.sh: Adriani (1990) theksoi se....., apo një studim i fundit nga (Adriani, 1990) tregon se ...
 - Për më shumë autorë shëno të gjitha emrat e autorëve herën e parë si: Filani, Fisteku, Fisniku dhe Adami (1990), kurse herën e dytë: Filani et al. (1990), me pikë pas “al”.
 - Shëno numrin e faqes që i referoheni, pas vitit si p.sh (Lopez, 1993, f. 311),
 - Nëse keni më shumë se një autor, duhet të duket si: (Smith, Jones, et al., 1991) ose (Smith, Burke, et al., 1991).
- **Format e referimit:**
 - **Nga autorë të panjohur (të marrë nga revistat):**
 - Caffeine linked to mental illness. (1991, July 13). *New York Times*, pp. B13, B15.

- **Nga librat:**
 - Strunk, W., Jr., & White, E. B. (1979). *The elements of style* (3rd ed.). New York: Macmillan.
 - American Psychiatric Association. (1990). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (3rd ed.). Washington, DC: Author.
 - Freud, S. (1961). The ego and the id. In J. Strachey (Ed. and Trans.), *The standard edition of the complete psychological works of Sigmund Freud* (Vol. 19, pp. 3-66). London: Hogarth Press. (Original work published 1923)
 - Referimi në tekst do të dukej si (Freud, 1923/1961).
- **Nga kapituj librash:**
 - Shapiro, K. L., & Raymond, J. E. (1994). Temporal allocation of visual attention: Inhibition or interference? In D. Dagenbach & T. H. Carr (Eds.), *Inhibitory mechanisms in attention, memory, and language*. New York: Academic Press.
- **Grup autorësh apo institucionesh:**
 - University of Pittsburgh. (1993) The title goes here. *Journal of Something*, 8, 5-9.
- **Nga artikujt shkencorë**
 - Spitch, M. L., Verzy, H. N., & Wilkie, D. M. (1993). Subjective shortening: A model of pigeons' memory for event duration. *Journal of Experimental Psychology: Animal Behavior Processes*, 9, 14-30.
- **Nga artikujt e revistave**
 - Gardner, H. (1991, December). Do babies sing a universal song? *Psychology Today*, pp. 70-76.
- **Mediet elektronike**
 - **FTP** : Bixley, T. S. (1995) *Sentient microfilaments: A tempest in a tubule*. [On-line]. Available: <ftp://blahblah.princeton.edu/pub/harnad/psyc.95.3.26/consciousness/11/bixley>.
 - **Gopher**: Bixley, T. S. (1995) *Sentient microfilaments: A tempest in a tubule*. [On-line]. Available:

gopher://somecomputer.princeton.edu/pub/harnad/psyc.95.3.26/consciousness/11/bixley.

- **World Wide Web page** : Bixley, T. S. (1995) *Sentient microfilaments Home Page*. [On-line]. Available: <http://www.microfilaments.com/consciousness/synchronicity/quantumtube.html>.

Mentorimi, konsultimet, vlerësimi dhe afati i dorëzimit

- Dekanati mund të kërkojë nga **profesorët që të publikojnë temat e mundshme të bachelorit**.
- **Me përfundimin e provimeve të parapara** me programin e studimeve, **studenti fiton të drejtën** e fillimin të procedurës së temës së bachelorit.
- Temat e bachelorit mund të merren vetëm nga **lëndët themelore nga fusha e ngushtë e studimit** në programin përkatës të studimit.
- Pas përfundimit të provimeve, studentit ka të drejtë që Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit **t'i drejtohet me kërkesë për lejimin e punimit të "punimit të diplomës", "tezat" dhe "projekt temën e bachelorit"**, po ashtu mund të propozojë mentorin dhe anëtarët e komisionit.
- **Këshilli Mësimor Shkencor** pas shqyrtimit të kërkesës për lejimin e temës së diplomës, vendos **për "lejimin" ose "refuzimin"** e punimit të temës së bachelorit.
- Me lejimin e temës së bachelorit, Këshilli Mësimor Shkencor **i fakultetit emëron komisionin prej tre anëtarësh**, prej tyre cakton kryetarin e komisionit dhe mentorin i cili do të punojë me kandidatin. Këshilli Mësimor Shkencor mund të marr vendim për plotësimin e komisionit në rast se njëri nga anëtarët tërhiqet nga komisioni, po ashtu mund të marr vendim për ndryshimin e komisionit nëse njëri nga anëtarët nuk i kryen detyrat e parapara.
- **Punimi i bachelorit duhet të jetë punë origjinale e kandidatit** dhe t'i përmbushë kriteret e standardeve profesionale, duhet të jetë i shkruar qartë në pajtim me rregullat e hartimit të punimeve shkencore, me një terminologji të përpunuar dhe me redakturë e teknike të përshtatshme.

- Studenti mund të zgjedh temën **nga lista e temave të bachelorit** të aprovuara nga dekanati që **shpallen tek referenti i fakultetit**, po ashtu mund të përcaktohet edhe për ndonjë temë tjetër me kusht që ajo temë mos të jetë shtjelluar gjatë tri viteve të kaluara.
- **Secili student** në Universitetin AAB **do ta ketë një mentor** për temën e tij/saj të Bachelorit (disertacionin). Do të keni takime të rregullta me mentorët tuaj. Ju i caktoni takimet me marrëveshje me mentorin tuaj.
- **Mentori/ja juaj duhet të ketë titullin profesor** apo doktor shkence apo PhD të mbrojtur, i/e cila do të ndihmojë dhe udhëheqë punën e studentit. Në parim, mentori duhet të **zgjidhet nga radha e profesorëve të fakultetit** dhe që ka përvojë në fushën në të cilën do të shtjellohet tema juaj. Pasi mentori ta pranojë tezën e përzgjedhur, studentin/ja i kërkon dekanatit të fakultetit miratimin e atij bashkëpunimi.
- Gjatë procesit të shkruarit të punimit, studentin duhet të ketë **konsultime të rregullta me mentorin e tij/saj**. Nuk është mirë që kandidati të punojë një kohë të gjatë në mënyrë të pavarur dhe pastaj ta konsultojë mentorin dhe t'ia dorëzojë një tërësi të madhe të punimit, pa marrë paraprakisht sugjerimet për çështjet më të vogla.
- **Konsultimet janë po ashtu edhe obligim i mentorit**. Pra, para përgatitjes së tezës përfundimtare, kandidati/ja është i/e obliguar që t'ia paraqes (së paku) një version mentorit dhe pasi ai/ajo të jetë pajtuar se punimi është i përfunduar, kandidati/ja e dorëzon punimin për shqyrtim.
- Punimi duhet të kryhet **brenda afatit të paraparë. Afati është 1 vit për të mbrojtur** temën e diplomës. Nëse ju e përfundoni më herët nuk shkakton problem.
- Nëse ju **duhet me shume kohë për të** përfunduar punimin e diplomës duhet e bisedoni me mentorin tuaj dhe me dekanatin. Afati mund të shtyhet me pajtimin e mentorit dhe dekanatit, nëse ka arsye të forta.
- **Kopja përfundimtare** duhet të jetë e përgatitur mirë dhe e kompletuar kur t'i **dorëzohet anëtarëve të komisionit për vlerësim**. Nëse ka komente të shumta, atëherë kandidati duhet ta korrigjojë serish temën, e nëse jo këshilli i fakultetit merr vendim që ta organizojë mbrojtjen: caktohet data dhe ajo shpallet publikisht.
- Secili student duhet ta mbrojë temën e diplomës së tij para komisionit, që përbëhen nga 2 anëtarë dhe mentori. **Studenti e mbron temën e diplomës me gojë para komisionit**, i cili përcaktohet nga dekanati. Nga 2 anëtarët e komisionit njëri nga ata është kryetari i komisionit. Mentori duhet të bëjë prezantimin e studentit dhe temës në pika të shkurta.
- Tema e bachelorit duhet të **mbrohet brenda 1 (një) viti** nga data e marrjes së vendimit për lejimin e temës.

- **Kandidati pasi përfundon punimin e bachelorit**, të njëjtin e dorëzon tek anëtarët e komisionit. Mentori në bashkëpunim me dy anëtarët tjerë të komisionit, për një periudhë **prej 7 ditësh obligohet** që të shkruajë referatin për kandidatin dhe temën e bachelorit, të njëjtin ta nënshkruajnë që të tre dhe ta dorëzojnë në Këshillin Mësimor Shkencor të Fakultetit.
- Nëse njëri nga anëtarët e komisionit ka mendim ndryshe, ai mund të hartojë referat të veçantë dhe të njëjtin të ja **bashkëngjis referatit kryesor**.
- **Këshilli Mësimor Shkencor pas pranimit të referatit nga komisioni, merr vendim për “miratim” apo “refuzim”**. Në rastin kur miratohet referati, me të njëjtin vendim cakton edhe datën e mbrojtjes së temës së bachelorit e cila nuk mund të jetë më herët se 7 ditë nga dita e marrjes së vendimit. Në rastin kur refuzohet referati, mundë të caktojë një afat prej 14 ditësh për plotësim dhe përmirësim.
- Kandidati punimin e bachelorit duhet ta dorëzojë në 6 kopje:
 - **Një kopje** në format origjinal (të përgatitur në libër A4) **për bibliotekën;**
 - **Një kopje** në format origjinal (të përgatitur në libër A4) **për Arkivin;**
 - **Një kopje** në format origjinal (të përgatitur në libër A4) **për dosjen e studentit;**
 - **Tri kopje** në format origjinal (të përgatitur në libër A4) **për secilin anëtarë të Komisionit;**
 - **Një CD në formatin PDF bibliotekën elektronike të AAB-së.**
- Mbrojtja e punimit të diplomës **bëhet publikisht para komisionit**, mësime të ndryshme, studentëve, kolegëve, familjarëve, miqve dhe të interesuarve tjerë.
- Kandidati prezanton **punimin e diplomës në formën që zgjedhë vetë (sllajdeve, fletëve etj)** varësisht prej llojit të punimit.
- **Kohëzgjatja e prezantimit është prej 15 deri 30 minuta**. Kryetari i komisionit pas përfundimit të prezantimit ju jep mundësinë anëtarëve të komisionit të bëjnë pyetje lidhur me punimin e diplomës dhe vetë prezantimin. Pyetje mund të parashtrijë edhe vet kryetari dhe audienca.
- Pas **përfundimit të prezantimit dhe pyetje/përgjigjeve, komisioni tërhiqet për 5 deri 15 minuta nga salla për të përfunduar vlerësimin e punimit të diplomës dhe prezantimin e kandidatit**. Secili anëtarë në mënyrë të pavarur dhe të barabartë propozon vlerësimin ndërsa kryetari bënë kalkulimin dhe vlerësimin përfundimtar. Studenti ka të drejtë të kërkojë pak kohë në mënyrë që t'i përgatisë përgjigjet.
- Vlerësimi i kandidatit mund të **jetë “me sukses” dhe “më sukses të dalluar”**.

- Pas rikthimit, kryetari i komisionit **shpall vendimin për përfundimin e temës, vlerësimin** e komisionit dhe titullin e arritur nga kandidati, një kopje e vendimit i dorëzohet edhe kandidatit.
- **Administrata, Arkiva, Referentet përgjegjës, janë të obliguar të mbajnë evidencën e rregullt** (kopjen e punimit të diplomës, kopjen e vendimit të komisionit dhe dokumenteve tjera) për të gjithë diplomantët.

Informacione teknike dhe informacione rreth pritshmërisë

Udhëzime mbi numrin e faqeve ose fjalëve

- Disertacioni apo tema e diplomës duhet të ketë **afërsisht 7 000 deri në 10 000 fjalë** të shkruara nga hyrja deri te konkludimi i punimit, **dhe kjo nuk përfshinë fjalët e përdorura për listimin e referencave dhe apendikset. Kjo i bie të shkruhen rreth 15 deri në 20 faqe të madhësisë A4**, por pa përfshi grafikët, tabelat, figurat dhe tjerat.
- Fakultetet mund të vendosin veçmas në sasinë e fjalëve ose faqeve që duhet të përgatiten për temën e Bachelorit. Studenti duhet të jetë në dijeni për këtë.

Udhëzime mbi margjinat, fontin dhe hapësirën në mes të rreshtave

- Dokumenti duhet të shkruhet në **MS Word, .doc, ose .docx**.
- **Madhësia e fontit** të përdorur duhet të jetë **12 për tekstin e shkruar, për kapitujt 16, për nënkapitujt 14, dhe për titullin e disertacionit në faqen e parë të jetë në një madhësi 20.**
- **Modeli i fontit** të përdorur duhet të jetë **Times New Roman**.
- **Hapësira** në mes të rreshtave duhet të jetë **1.5**.
- **Teksti** duhet të jetë **Justified**. Selektoto tekstin dhe shtype në tastatur CTRL+J.
- **Margjinat** duhet të jenë të njëjta në të gjitha anët. Klikoni në Page Layout dhe zgjidhni **Normal**.

Nga:

Zyra për Sigurimin e Cilësisë
Universiteti AAB, Kosovë
<http://www.universitetiaab.com/>
<http://www.aab-edu.net/>



BPrAL AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

2014